



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA  
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

---

**Kom.Dh.Shk.II.nr.998/23**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së dytë**, gjyqtari Dren Rogova, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Komuna Hani i Elezit”, me seli në Hani Elezit, kundër debitorit “Telekomi i Kosovës”, me seli në rr. Dardania p.n., në Prishtinë, në çështjen përmbartimore, për shkak të borxhit në bazë të dokumentit përmbartimor, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.535/22 të datës 31.03.2023, më datën 14.11.2023, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e kreditorit “Komuna Hani Elezit”, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.535/22 të datës 31.03.2023, VËRTETOHET.

**A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë, me aktvendimin e atakuar, KPPP.nr.535/22 të datës 31.03.2023, në piken I të dispozitivit e ka pranuar si të bazuar propësimin e debitorit “Telekomi i Kosovës” me seli në Prishtinë, dhe e ka anuluar Urdhri Përmbartimor P.nr.202/2020 të datës 22.10.2020 të Përmbartuesit Privat Sheremet Livoreka dhe e ka përfunduar në tërësi përmbartimin në këtë çështje përmbartimore.

Ankesë ka paraqitur në afat ligjor kreditori dhe atë për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave kontestimore, Konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që aktvendimi i atakuar të priset apo të kthehet në rishqyrtim të e njëjta gjykatë apo të miratohet në tërësi ankesa e kreditorit në mënyrë që urdhri përmbartimor P.nr.202/2020 i datës 22.10.2020 i Përmbartuesit Privat Sheremet Livoreka të mbetet në fuqi.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur debitori “Telekomi i Kosovës”, me seli në rr. Dardania p.n., në Prishtinë, me propozim që të hedhet poshtë ankesa e paraqitur nga kreditori.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit nr.04/L-139 për procedurën përbarimore si dhe në kuptim të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori “Komuna Hani Elezit”, me datën 22.10.2020 ka paraqitur propozim për përbarim ndaj debitorit “Telekomi i Kosovës”, rruga Dardania p.n., Prishtinë, në bazë të dokumentit përbarimor Vendimit të Drejtorisë së Shërbimeve Publike 10.nr.4800/2020 në emër të borxhit të përcaktuar sipas vendimit në shumën prej 1,800.00€, si dhe ka kërkuar shpenzimet e procedurës përbarimore.

Përbaruesi Privat, me Urdhrin Përbarimor P.nr.202/2020 të dt.23.10.2020, ka caktuar përbarimin, duke vlerësuar se dokumenti përbarimor Vendimit të Drejtorisë së Shërbimeve Publike 10.nr.4800/2020, i plotëson kushtet për përbarim.

Ndaj këtij urdhri ka paraqitur prapësim debitorit, duke e kundërshtuar në tërësi urdhrin për përbarim për shkak se dokumenti në bazë të cilit është nxjerrë urdhëri përbarimor nuk përmban vulën e ekzekutueshmërisë dhe plotfuqishmërisë, përkatësisht dokumentet e bashkangjitura nuk e kanë cilësinë e dokumentit të besueshme, sikurse është parapare me nenin 29 të LPP-së. Me tutje ka deklaruar se Urdhri Përbarimor është në kundërshtim me dispozitat e nenit 40 pikë 1.3 të Ligjit Nr.04/L-139 të LPP-së, për shkak se nuk janë bashkangjitur prova, respektivisht objekti i përbarimit e që në rastin konkret nuk janë bashkangjitur faturat në origjinal dhe as që i janë dorëzuar kreditorit të përbarimit. I ka propozuar gjykatës që të aprovohet në tërësi prapësimi i debitorit dhe të anulohet urdhri i përbaruesit privat dhe të obligohet kreditori që ti bartë shpenzimet e procedurës përbarimore.

Përgjigjen në ankese ka parashtruar kreditori ndaj prapësimit të debitorit, duke e kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit si të pabazuara duke shtuar se debitorit e ka pranuar faturën origjinale. Me tutje kreditori ka deklarua se ka bashkangjitur si provë edhe vendimin Nr.10.4800/2020 i cili në procedurën administrative është vendim përfundimtar, i ka propozuar gjykatës që ta refuzojë si të pabazuar prapësimin e debitorit, ndërsa urdhrin përbarimor P.nr.202/202 të datës 22.10.2020 ta lë në fuqi.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e shkallës së parë, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.535/22 të datës 31.03.2023, ka pranuar në tërësi prapësimin e debitorit, duke vendosur si në dispozitiv.

Në arsyetim të aktvendimit të atakuar ka theksuar se pas analizimit të propozimit për përbarim e konteston se i njëjti është lejuar mbi bazën e dokumentit përbarimor Vendimit të Drejtorisë së

Shërbimeve Publike 10.nr.4800/2020 në emër të borxhit të përcaktuar sipas vendimit në shumën prej 1,800.00€. Prandaj ka theksuar se prapësimi i debitorit është bazuar në nenin 69 lidhur me neni 71 paragrafi 1.1 të Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, andaj të njëjtin në kuptim të nenit 73 paragrafi 3 i LPP-së, vendosi që ta pranoj si të bazuar. Po ashtu, Gjykata e shkallës së parë ka theksuar se në rastin konkret Vendimi me Nr. 10.4800/2020, në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbartim , nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 22 par.1 dhe 24 par.3 të LPP-së.

Vlerësimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë, në bazë të nenit 194 të LPK-së, i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare.

Gjykata Komerciale – Dhomat e shkallës së dytë nuk i pranon pretendimet ankimore për shkelje të dispozitave të ligjit të procedurës përmbartimore, pasi që gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar drejtë provat të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës të ofruara nga ndërgjyqësit, ka vendosur drejtë në dispozitiv të aktvendimit, duke dhënë arsye përkatëse në pjesën arsyetuese të aktvendimit të atakuar dhe drejtë ka aplikuar edhe Ligjin e Procedurës Përmbartimore, Kjo gjykate vlerëson se në rastin konkret Vendimit të Drejtorisë së Shërbimeve Publike 10.nr.4800/2020 për shumën në lartësi prej 1,800.00€ në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbartim , nuk i plotëson kushtet për të qene dokument përmbartimor me titull ekzekutiv, sepse nuk i përmban të gjitha elementet e kërkuara në përputhje me nenin 22 par.1 dhe 24 par.3 të LPP-së.

Gjykata Komerciale, Dhomat e shkallës së dytë, vlerëson se dokumenti mbi të cilin është lejuar përmbartimi , vendimi për kryerjen e pagesës për vazhdim qëndrimin e antenave në pikat ekzistuese Nr.10.4800/2020 i datës 20.10.2020 nuk përben bazën juridike për caktimin e përmbartimit, pasi që nuk paraqet tiull ekzekutiv sipas nenit 21 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore, në të cilin përcaktohet se “ *Organi përmbartues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbartimin vetëm në bazë të dokumentit përmbartues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshme, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër*” dhe nenit 22 par.1 pika 1.2 të LPP-së, me të cilin përcaktohen dokumentet përmbartuese siç janë “*Vendimi përmbartues i dhënë në procedurë administrative dhe aktpajtimi*”. Në rastin konkret Vendimi me Nr.10.4800/2020 të datës 20.10.2020 nuk i përmban elementet e një vendimi të organit administrativ , dhe se nuk e ka cilësinë e dokumentit përmbartues sipas nenit 23 par.2, 24 par.3 të LPP-së. Po ashtu dokumentit/ vendimit Nr.10.4800/2020 i mungon forma e aktit administrativ, struktura dhe elementet e detyrueshme të aktit administrative të përcaktuar me dispozitat e nenit 47 dhe 48 të (Ligjit 05/L-031) për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe si të tilla nuk mund të konsiderohet dokument përmbartimor sipas nenit 22 të LPP-së.

Andaj, Gjykata Komerciale – Dhomat e shkallës së dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejte ka vendosur kur e ka aprovuar në tërësi prapësimin e debitorit, me arsyetimin se në bazë të shkresave të lendes rezultoi se vendimi mbi të cilin përmbaruesi privat e ka lejuar urdhrin përmbarimor të debitorit me Nr.10.4800/2020 të datës 20.10.2020 nuk paraqet dokument përmbarimor në kuptim të dispozitave të LPP-së, për shkak se nuk përmban vulën e ekzekutueshmërisë dhe plotfuqishmërisë, si dhe vendimi mbi bazën e të cilit është nxjerrë urdhri përmbarimor nuk i plotëson kushtet në kuptim të nenit 22 par.1 të Ligjit për Procedurën Përmbarimor.

Dhomat e shkallës së dytë të Gjykatës Komerciale, i vlerësoi të gjitha pretendimet ankimore të kreditorit por të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi. Nëse pala kreditore për çfarëdo rrethane apo arsye pretendon se pala debitorë ka mundur ti shkaktohet apo mund ti shkaktohet çfarëdo lloji dëmi më rastin e mos kryerjes së përmbarimit sipas kësaj lënde, nuk ka pengesa ligjore që lidhur më këtë të drejtën e tij ta realizoj në kontest të rregullt pranë gjykatës kompetente.

Andaj, duke marr parasysh pretendimet ankimore, të cilat konsistojnë ndaj aktvendimit të ankimuar, gjykata e shkallës së dytë konsideron se këto pretendimet ankimore janë të pabazuara, ngase nuk kemi të bëjmë me shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore, të cilat shkelje kjo gjykatë i vështron sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, dhe as të Ligjit të Procedurës Përmbarimore. Andaj me të drejtë gjykata e shkallës së parë e ka aprovuar prapësimin e debitorit dhe e ka anuluar urdhrin për caktimin e përmbarimit të Përmbaruesit Privat, P.nr.202/2020 të dt. 22.10.2020.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika b) të LPK-së lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## **GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**

**Dhomat e shkallës së dytë**

**Kom.Dh.Shk.II.nr.998/23 dt. 14.11.2023**

**Gjyqtari,  
Dren Rogova**